

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

ZYRA E ADMINISTRATORIT

Gjirokastrë, më 12/01/2018

DETAJIMI I BUXHETIT PËR VITIN 2018

PËRGATITUR NGA ADMINISTRATORI I UNIVERSITETIT

DREJTUAR:

SENATIT AKADEMIK

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

Në zbatim të ligjit Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit Nr.109/2017, “Për buxhetin e vitit 2018”, të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, “Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 49,pika c ,të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 ”Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar si dhe të shkresës Nr.... datë..... të MAS-it (bashkëngjitur), bëhet detajimi i trasfertës së pakushtëzuar e cila është në një vlerë prej **274.992.000** lekë si edhe të ardhurave dytësore në vlerën **75.238.000** lekë.

Trasferta e pakushtëzuar do të planifikohet për të përballuar pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore nga punëdhënësi,bursat e studentëve si dhe një pjesë të shpenzimeve operative për vitin 2018, duke u nisur nga disa priorite për institucionin si :

1-Rritjen e qëndrueshme afatmesme të të ardhurave të institucionit.

2-Vazhdimin e ristrukturimit të mësimdhënies dhe aftësimin profesional.

3-Integrimin e veprimtarisë kërkimore –shkencore me atë të mësimdhënies në nivele reale dhe jo vetëm teorike, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe aftësimin profesional të studentit për të patur një impakt pozitiv në zhvillimin e rajonit.

4-Përmbushjen e të gjitha standarteve mbi të cilat do të bëhet akreditimi i institucionit tonë në vazhdimësi duke pasur në vëmendje strategjinë e institucionit.

Në zbatim të Ligjit të ri të Arsimit të Lartë, neni 112, nga ana jonë për këtë planifikim do të merren parasysh të gjitha kërkesat e këtij Ligji, duke parë kushtet reale të funksionimit të institucionit tonë, si në lidhje me strukturat e përcaktuara në të, po ashtu edhe në lidhje me nivelin e të ardhurave që realizon institucioni

Trasferta e pakushtëzuar për vitin 2018 është e mjaftueshme për të përballuar të gjithë fondin e domosdoshëm për paga e sigurime shoqërore, referuar edhe tabelës analitike të fondit të pagave në projekt buxhetin e vitit 2018, si edhe realizimit faktik për vitin 2017. Nga përlllogaritja e fondit për pagat sipas strukturës organike aktuale të Universitetit dhe kontributit të sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi, duke marrë në konsideratë strukturën e kualifikimit të stafit akademik dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 268 datë 29.03.2017, "Për disa ndryshime në VKM. Nr.748 datë 11.06.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit Akademik të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë, i ndryshuar ", të VKM-së Nr. 329 datë 11.05.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik" ,të VKM-së Nr. 187 datë 08.03.2017 "Per miratimin e strukturës së pagave të nëpunësve civilë ,nëpunësve ... në institucionet në varësi të ministrave të linjës ", të VKM-së Nr. 202 datë 15.03.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr.717 datë 23.06.2009 "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore " të ndryshuar kemi patur parasysh faktin se numri i pedagogëve që kanë mbaruar studimet pasuniversitare për kalimin e shkallëve të kualifikimit është rritur si dhe të titujve që mbajnë aktualisht, mbi ndryshimet e miratuara deri tani në strukturën e Fakultetit Ekonomik, si dhe për ndryshimet e reja në personel,sipas Ligjit të ri të Arsimit të Lartë,për fondin e pagave, përlllogaritim si më poshtë:

- SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONIT NGA GRANTI

1-PAGAT

Stafi akademik dhe personeli mbështetës planifikohet fond page në vlerën – **200.000.000** lekë.

2- SIGURIME SHOQËRORE

Sipas ligjit në fuqi për "Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", vlera vjetore e këtyre kontributeve , e llogaritur (16.7% të fondit të pagës) është **30.000.000** lekë .

3-BURSAT E STUDENTËVE

Sipas ligjit në fuqi Nr. 903 datë 21.12.2016 i ndryshuar planifikohet fond në vlerën **4.500.000** lekë

4 - SHPENZIME OPERATIVE

në vlerën prej **40.492.000** lekë do të planifikohet të përdoret duke përfshirë edhe transfertat me jashtë shtetit (**500.000** lekë).

SHPENZIME NGA TË GRANTI PËR INSTITUCIONIN	
Paga	200.000.000
Sigurime shoqerore e shendetesore	30.000.000
Bursa	4.500.000
Shpenzime Operative	40.492.000
TOTAL	274.992.000

Nga ana jonë është planifikuar fond page për një strukturë sa më eficiente dhe radikale , kushtëzuar kjo nga niveli i fondit të pagave të përdorur për 2017 sipas zërave, si edhe i të ardhurave që realizojmë .

- SHPENZIME PËR MIRËMBAJTJEN DHE FUNKSIONIMIN E INSTITUCIONIT NGA TË ARDHURAT DYTËSORE

Kriteret e Shpërndarjes së të Ardhurave

- 1- Për financimin e aktiviteteve (ose shpenzime) me karakter të drejtpërdrejtë për forcimin dhe thellimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- 2- Financimin e aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit mbi baza reale dhe për nevoja të domosdoshme të funksionimit të tij.
- 3- Promovimin e Universitetit tonë në Rajonin Jugor edhe më gjerë .
- 4- Mbështetjen financiare të procesit të çeljes së kuotave të ciklit të tretë (të studimeve në doktoraturë).
- 5- Mirëmbajtjen e infrastrukturës së institucionit dhe të sistemit të të dhënave që është implementuar me vite në Universitet.
- 6- Financim për aktivitete shkencore, ku nga produktet e tyre do të kenë përfitim të drejtpërdrejtë komuniteti i qytetit, qarkut e me gjerë.
- 7- Financime për qeverinë studentore për aktivitete të ndryshme me karakter social-kulturor, apo aktiviteteve bashkëpunimi me qeverinë studentore të universiteteve të tjera, brenda apo jashtë vendit.

Në planifikimin e Shpenzimeve nga të ardhurat dytësore janë përcaktuar limite të përdorimit të fondeve në nivel të domosdoshëm, kushtëzuar nga sasia e të ardhurave që parashikohen të realizohen. Nisur nga numri aktual i studentëve, numrit të tyre që paraqesin dokumenta për tu përjashtuar nga pagesa e tarifës së shkollimit për arsye se u përkasin shtresave në nevojë pavarësisht se ne kemi planifikuar 85.917.000 lekë në projekt buxhetin e 2018 mendojme se të ardhurat e krijuara do të jenë në vlerën 50.000.000 lekë .

. Duke analizuar vështirësinë financiare të financimit nga të dy burimet si nga Buxheti i Shtetit po ashtu edhe nga të ardhurat dytësore, por edhe domosdoshmërinë e kryerjes së disa shpenzimeve për funksionimin normal akademik dhe administrativ të institucionit, planifikimi i fondeve të detajuara për tu shpenzuar nga të ardhurat sipas zërave janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

SHPENZIME NGA TË ARDHURAT DYTËSORE TE INSTITUCIONIT	
Paga	20.000.000
Shpenzime operative	5.878.000
Studime projektive investime	49.360.000
TOTAL	75.238.000

Kemi planifikuar një fond prej 20.000.000 lekë për pagesën e pedagogëve të jashtëm si edhe për orët e mbi normës për stafin akademik. .

“Planifikimi i zërave të shpenzimeve operative për vitin 2018, krahasimisht me faktin 2017

	Objekti i Prokurimit	Fondi limit i parashikuar(grant e të ardhura 2018)	Vlera e realizuar 2017
	Roje civile(kontrate shtese)	870.972	907.000
	Roje civile	5.127.674	4.787.997
	Karburant	1.700.000	3.999.936
	Kanceleri ,boje,fotokopje,printeri etj.	150.000	76.080
	Kanceleri, shtypeshkrime, bojra	1.900.000	2.152.644
	Materiale pastrimi	240.000	202.314

	Shërbime kompjuterike	250.000	82.800
	Mirembajtje fotokopjuesi	250.000	142.680
	Materiale elektrike, hidraul,ndertimi.	230.000	238.680
	Te tjera materiale zyre,	290.000	134.468
	Energji	2.000.000	2.330.219
	Uje	500,000	822.222
	Telefon	650.000	670.699
	Sherbim postar	140.000	132.768
	Sherbime te ndryshme	700.000	368.014
	Mirembajtje mjet transporti (dy mjete)	600.000	934.200
	Materiale dhe sherbime specifike	700.000	591.777
	Kuota e sigurimit te mjeteve	200,000	128.512
	Sherbime Interneti,	250.000	122.303
	Miremb te aparateve kondicioner,kaldaje, gjenerator	500.000	247.560
	Kosto reklam.dhe publik.	1.600,000	138.663
	Kosto legale(abonime etj.miremb kontrate)	150.000	108,000
	Kosto te seanc bordeve ,mbledh senati	2.616.000	2.560.959
	Dieta, brenda ,jashte, ekspedita	4.440,000	3.438.199

Sherbime te printimit dhe publikimit	350,000	0
Mirembajtje e godinave	3.145.354	291.660
Shpenzime pritje e percjellje	600,000	456.670
Shpenzime për konferenca kombetare apo veprimtari locale etj	6.000.000	36.000
Aktivite shkencore departamente	0	42.000
Konf.Ndërkomb.shkencore	0	727.378
Projekt shkencor Ekonomiku	0	0
Mirëmb. riparime Laboratori I gjuhëve të huaja	0	0
Mirëmbajtje sistemi i infor.dhe sistemi alarmit,antivirus	380.000	250.800
Shpenzime per Qeverine Studentore	2.400.000	714.660
Taksë antaresim ne organizata universitare 605	500.000	488.090
Mirembajtje sistemi elektrik	280.000	
Ndricimi i ambjenteve te jashtme	580.000	
Mirembajtje sistemi i fonise	250.000	
Ndricimi i brendshem (senat, auditor)	100.000	
Sherbime te tjera (pagesa senat, bord etj)	5.730.000	
Shpenzime për akreditimin	0	1.128.000

Totali I shpenzimeve operative	46.370.000	29.453.962
---------------------------------------	-------------------	-------------------

Sipas tabelës së mësipërme argumentojmë planifikimin e nivelit të fondit për cdo zë si më poshtë:

Në zërin Kancelari, bojra shtypshkrime etj : Parashikohet në vlerën **2.050.000 lekë** për të përballur furnizimin e institucionit me bazë materiale kancelarike, tonera dhe shtypshkrime, etj. Një peshë të konsiderueshme e kemi parashikuar nga granti .parashikohet në këtë zë për nevoja imediate të departamenteve e administratës .

Në zërat e tjerë : materiale pastrimi 240.000 lekë , materiale hidraulike dhe elektrike 230.000 lekë, shërbime kompjuterike 250.000 lekë, mirëmbajtje fotokopjuesish 250.000 lekë, mirëmbajtje kondicioner,kaldajë e gjeneratorë 500.000 lekë të tjera materiale zyre 290.000lekë , krahasimisht me vitin 2017,është parashikuar thuajse në vlere të njëjtë ose më të vogël për arsye të reduktimit në maksimum të shpenzimeve të këtyre zërave dhe duke përdorur me efektivitet sasitë e tyre si ato të reja dhe ato që janë gjendje në magazinë. Fakti që këto shpenzime do të mbulohen një pjesë nga të ardhurat dytësore është planifikuar në një vlerë që mbulon nevojat e domosdoshme të institucionit për gjithë vitin kalendarik 2018. Edhe pse do të blihen paisje të reja, fotokopje dhe kompjutera, nga viti në vit numri i paisjeve që janë blerë vite më parë, përbëjnë pjesën dërrmuese në infrastrukturën elektronike të Universitetit. Këto paisje kanë edhe nje kosto të konsiderueshme për riparim dhe mirëmbajtje pasi nga viti në vit amortizohen ose kanë dëmtime mekanike të pjesëve të tyre. Këto paisje nuk mund të dalin të gjitha jashtë përdorimit, pasi nuk mund të planifikojmë fonde për blerje paisjesh të reja në nivele të larta si dhe për faktin që afati kohor i amortizimit nuk ka kaluar për to. Mirëmbajtje kondicioner në vlerën 300.000 lekë, ku me këtë fond do të trajtohet mirëmbajtja e kondicionerëve që janë me difekt. Riparimet e tyre shkojnë nga defekte të vogla 2.000 lekë deri në riparim motori në vlerën 15.000 lekë(kuptohet në raste shumë të rralla sepse kostoja e këtij riparimi është e madhe. Fondi është planifikuar për riparim të tyre në një vlerë mesatare 4.000 lekë /kondicioner në vit, bazuar kjo në realizimin e shpenzimeve të viteve të kaluara.

Në zërin Materiale dhe Shpenzime specifike, parashikohet në një nivel të konsiderueshëm prej 700.000 lekë për të përballuar shërbime të ndryshme sipas rastit të cilat janë konsideruar si të domosdoshme nga ana jonë nga praktika e viteve të kaluara.

Në zërat energji, ujë dhe telefon janë shpenzime me karakter tarifor dhe është parashikuar në vlera të tilla edhe nga ndryshimet që kanë pësuar këto tarifa gjatë viteve të kaluara.

Në zërin e energjisë elektrike është parashikuar një vlerë prej 2.000.000 lekë për ambjentet ekzistuese. Meqënëse sivjet do të bëjmë rikonstruksionin e objektit, do të jetë i domosdoshëm shfrytëzimi i rrjetit të energjisë elektrike për kryerjen e punimeve në këtë objekt.

Për zërin telefon parashikohet pagesa për telefoninë fikse por edhe atë celulare sipas ***VKM-së Nr.864 datë 23.07.2010*** "Për paisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publik", ku lejohen të trajtohen me pagesën mujore punonjësit e Universitetit sipas pikës 8 dhe 9 të Vendimit të mësipërm dhe kjo vlerë përlllogaritet në total 650.000 lekë, vlerë e cila nuk e tejkalon 2% e vlerës së përgjithshme të institucionit të planifikuar për shpenzimet operative, sic kërkohet në këtë vendim. Nga praktika e viteve të kaluara ka rezultuar se ky fond nuk konsumohet totalisht pasi nga punonjësit përfitues të këtij shërbimi nuk konsumohet e gjithë vlera mujore e përcaktuar për secilin. Për ujin është planifikuar në vlerën 500.000 lekë por duke pasur parasysh që në qoftë se do të duhen fonde në vazhdim do të alokojmë sipas nevojave .

Në zërin Shërbimi postar, parashikohet në vlerën 140.000 lekë për të përballuar pagesat për shërbimin postar të thjeshtë kryesisht, por edhe shërbimin me postë të shpejtë për ato raste kur gjykohet nga titullari se duhet të përdoret ky shërbim.

Shërbimi bankar parashikohet në vlerën 50.000 lekë për komisione bankare të ndryshme kryesisht për abonimet jashtë shtetit që i kemi përfshirë tek shpenzimet te mdryshme

Në zërin Shërbime të printimit (reklamimit) dhe publikimi dhe buletinet parashikohet një vlerë prej 1.600.000 lekë Do të përballohen shpenzimet për përgatitjen dhe botimin e periodikëve "Kërkime Universitare", për vitin 2018. Në këtë fond është planifikuar edhe pagesa e redaksisë për përgatitjen e materialeve të këtyre buletineve si dhe mundësimi i botimit të ndonjë periodiku shtesë nga materialet e konferencave të ndryshme që mund të zhvillohen nga Departamentet e Universitetit tonë. Pagesa e redaksisë që merret me përgatitjen e buletinit bëhet sipas vendimit Nr.120 datë 27.01.1997 "Për shpërblimin e autorëve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor", ndërsa botimi i buletinit bëhet konform procedurave të prokurimit publik të përcaktuar në Ligjin e prokurimeve. Mendojme që tirazhi i botimeve të jete më i reduktur. Një vëmendje e vecantë do ti kushtohet nga ana jonë promovimit të Universitetit tonë gjatë gjithë vitit me qëllim arritjen e objektivave si më poshtë;

- ardhjen e sa më shumë studentëve.
- rritjen e impaktit pozitiv në komunitetin e rrethit te Gjirokastrës dhe më gjerë.
- rritjen e kontributit ne jetën dhe cilësinë e jetesës së këtij komuniteti .

Zëri Kosto trajnimit dhe seminareve (të seancave e bordeve, mbl.senati) është parashikuar nga përllogaritjet në vlerën **2.616.000** lekë, ku përfshihet shuma vjetore e tarifave (8.000 lekë/ muaj) ,por ne kemi planikuar edhe një zë në rregjistër me vlerë **5.730.000** lekë për cdo ndryshim të mundshëm në vlerën e pagesës për cdo mbledhje në vazhdim i apo edhe për nevoja të tjera imediate që mund të na lindin gjatë permbushjes së aktivitetit financiar;

-për mbledhjet e senatit, (për nëntë muaj),

-mbledhjet e anëtarëve të Bordit të Administrimit (për 12 muaj),

-mbledhjet e cdo strukture tjetër që do të mbahen gjatë vitit, mbështetur këto sipas udhëzimeve në fuqi (VKM nr. 748 date 11.06.2009 i ndryshuar) dhe vendimeve të tjera që mund te botohen apo do të merren nga organet kompetente.

-pjesmarrje në aktivitete të tjera

Në zërin Shërbime të tjera kemi parashikuar vlerën prej 650.000 lekë dhe 50.000 lekë kemi planifikuar për shpenzimet bankare ku parashikohen : kryerja e shpenzimeve për shërbime të ndryshme që janë të domosdoshme për funksionimin e institucionit si: akte teknike të funksionimit të institucionit (te mbrojtjes nga zjarri, të raporteve higjeno –sanitare), hostim të faqes së UOGJ, dhe shërbime të tjera të cilat mund të jenë specifikish për një vit buxhetor.

- Në zërin karburant është planifikuar një fond prej 1.700.000 lekë, krahasimisht më i vogël me atë të vitit 2017, kjo nisur nga sasia e karburantit që kemi gjendje .Për vitin 2018 planifikojmë karburant për sistemin e ngrohjes dhe për lëvizjen e mjeteve të transportit të Universitetit. Në krahasim me vitet e kaluara është planifikuar në total një vlerë më e vogël për karburant. Sasia për mjetet e transportit është planifikuar më e ulët se vitet e kaluara dhe është mbajtur në vlerë kostante sasia e karburantit për kaldajat në funksion të ngrohjes së godinave, me qëllim krijimin e kushteve optimale jo vetëm në ambientet e zyrave ku kanë edhe ngrohje alternative, por edhe për sallat e leksioneve dhe seminareve.

Në zërin dieta brenda e jashtë vendit, ekspedita është parashikuar në një vlerë totale prej 4.440.000 lekë, ku do të përballohet lëvizja e stafit akademik dhe administrativ jashtë rrethit dhe jashtë vendit, për seminare, trajnime, konferenca, aktivitete dhe projekte të ndryshme, si dhe për praktikantët mësimorë të studentëve. Këto praktika do të planifikohen të bëhen në terren, duke përballuar lëvizjen e studentëve jashtë rrethit dhe qytetit me transport urban dhe pagesë hoteli për akomodimin e tyre në rast se do të ketë intenerare të tilla.

Në zërin mirëmbajtje mjete transporti: parashikohet në një vlerë 600.000 lekë. Ashtu si edhe më parë peshën më të madhe të këtyre shpenzimeve e zë mjeti furgon pasi është mjet që është blerë prej mbi 10 vitesh dhe ka një amortizim më të lartë nga viti në vit. Në kushtet e sotme të sasisë së të ardhurave që realizon institucioni, nuk mund të planifikohet blerja e një mjeti të ri, pasi edhe nga vlerësimi i tregut për blerjen e këtyre mjeteve të transportit do të ketë një kosto të konsiderueshme, shumë herë më të lartë se vlera e mirëmbajtjes së tij.

Në zërin mirëmbajtje paisje zyre ku përfshihet

a- Mirëmbajtje të sistemit të Alarmit dhe të sistemit elektrik ku parashikohet një fond prej 280.000 lekë, që do të shpenzohet për mirëmbajtjen e këtij sistemi nga dëmtimet e mundshme në: linjat kablllore të sistemit nëse do të ketë, pastrimi, testimi me aerosol i dedektorëve të server room-it, ndërrimi i dedektorëve që mund të dëmtohen me kalimin e kohës, ndërrimi i baterive të ushqimit të mini inverterave etj. si edhe janë planifikuar edhe 100.000 lekë për blerje antivirus .

b- Mirëmbajtje sistemi i fonise 250.000 lekë, ndricimi i jashtëm 580.000 lekë dhe ndricimi i brendshëm 100.000 lekë. Ky planifikim për vitin aktual është i domosdoshëm duke marrë parasysh gjendjen aktuale të tyre .

Në zërin konferenca kombëtare, veprimtari lokale, ktivitete, kërkime shkencore etj kemi planifikuar 6.000.000 lekë për ti dhënë përparësi kërkimit shkencor, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare. Mendojmë që për pjesmarrjen në konferenca të organizuara nga Universiteti yne te bëhet pagesa e *fee*-së në masën 5000 lekë.

Kosto legale (mirëmbajtje kontrate) kemi planifikuar nje fond prej 150.000 lekë ku parashikohet kontrata e mirëmbajtjes së programit të zyrës së financës e personelit, Alfa Buxhetor në vlerën 108.000 lekë si dhe detyrime të tjera.

Në zërin Shpenzime për Qeverinë Studentore: si një nga rekomandimet e grupit të ekspertëve për akreditim, është planifikuar një vlerë prej **2.400.000 lekë**. Është parë e arsyeshme të akordohet dhe të menaxhohet ky fond me qëllim aktivizimin dhe mbështetjen e studentëve në veprimtaritë social-kulturore dhe shkencore për të qënë jo vetëm kontribues për krijimin e të ardhurave për institucionin, por edhe protagonist për veprimtari të cilat kanë një ndikim pozitiv në jetën e Universitetit, e qytetit dhe të rajonit të jugut. Edhe pse nuk është hartuar akoma një rregullore e funksionimit të qeverisë studentore sipas ligjit të ri, nga ana jonë planifikohet ky fond për të mbështetur qeverinë studentore për të financuar veprimtaritë e tyre, sipas nenit 99, pika 6 e ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Per Arsimin e Larte dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë".

Në zërin Shpenzime për pritje përcjellje kemi planifikuar një fond prej 600.000 lekë duke marrë parasysh edhe shpenzimet për festimin e 50- vjetorit të Universitetit.

Për zërin “Trasferta të jashtme” 605 , planifikohet një fond prej 500.000 lekë për arsye të aderimit të institucionit tonë në organizata ndërkombëtare akademike, të cilat rrisin prestigjin e institucionit tonë, parë kjo si të domosdoshmëri edhe për procesin e akreditimit të Universitetit tonë në të ardhmen .

Konkretisht kemi planifikuar në këtë zë tre abonime të cilat kanë qënë të përvitshme dhe janë konsideruar prestigjoze nga ana jonë për faktin që kanë ndikim pozitiv për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe azhurnimin me literaturë bashkohore të stafit akademik,për zhvillimin e karrierës së mëtejshme të tyre . Abonimi në organizatën universitare ndërkombëtare “International Association of Universities ” në vlerën 1500 Euro prej më shumë se pesë vitesh, ku kemi edhe te drejtën e votimit për vendimet që merren në këtë organizatë, si dhe pagesa për antarësimin e Departamentit të Matematikës të Universitetit tonë në periodikun Ndërkombëtar “Springer” , ku pagesa e abonimit është 367.5 € , abonimi në site : [http:// ëëë.tradingeconomics.com/analytics](http://ëëë.tradingeconomics.com/analytics), ku vlerësohet nga departamentet tona si një database i plotësuar me informacione ekonomike, shkencore të të gjitha fushave dhe që mund të përdoret nga të gjithë antarët e personelit akademik të universitetit tonë dhe jo vetëm nga Departamentet e Ekonomikut.Ky abonim është në vlerën 2.000 euro në vit.

Nëse gjatë vitit pranë zyrës së Administratorit do të paraqiten kërkesa nga Departamentet për abonime të tjera,ato do të trajtohen me përparësi.

Në zërin Shpenzime për mirëmbajtjen e godinave është planifikuar në vlerën prej 3.145.354 lekë ku përfshihen mirëmbajtje e murit rrethues, sistemimi i zyrave në katin e parë të godiës kryesore, ambjentit të jashtëm etj.

FONDI PËR INVESTIME NGA TË ARDHURAT DYTËSORE kemi planifikuar 49.360.000 lekë

KRIJUAR DHE PERDORUR PER VITIN 2018	GJITHSEJ	INSTITUCIONIT
Sipas celjes së dt. 01.01.2017		65.615.433
Krijuar gjate vitit 2017		49.688.000
SHUMA E TE ARDHURAVE (1+2+3+4)		115.303.433
Perdorur gjate vitit 2017 nga institucioni		24.669.040
SHUMA E PERDORUR (5+6)		24.669.040
Gjendje me 31.12.2017 për përdorim në 2018.		90.635.218

Planifikimi i nevojave për investime për vitin 2018 është bërë mbi një bazë reale kërkesash, të cilat janë paraqitur nga Departamenteti si edhe nga nevojat e evidentuara në institucion me argumentimet përkatëse. Në planifikimin e investimeve nga ana jone i është dhënë përparësi rikonstruksionit të godinës ish Shtëpia e Ushtarakëve.

Duke trashëguar 90.635.218 lekë për investimet 2018 jemi fokusuar në :

a) realizimin e rikonstruksionit për ish shtëpinë e ushtarakëve në vlerën prej 38.097.785 lekë,leje ndërtimi, kolaudim e supervizim në vlerën prej 1.902.215 lekë dhe rishikim i projektit në vlerën 2.400.000 lekë.

b)përshtatjen e ambjenteve për sekretaret planifikuar në vlerën 2.000.000 lekë për një shërbim më cilësor ndaj studentëve.

Nisur nga niveli i realizimit të të Ardhurave Dytësore për vitin 2018 dhe nga politika që duhet të ndjekim si institucion për rritjen e qëndrueshme afatmesme të të ardhurave, planifikuam për investime vetëm për kërkesa imediate dhe që janë konsideruar si domosdoshmëri për funksionimin e infrastrukturës, si më poshtë:

c)Pajisje kompjuterike planifikohet fond në vlerën 800.000 lekë, për plotësimin e kërkesave parësore,të cilat do të merren në konsideratë bazuar në nevojat e Departamenteve.Miratimi i Fakultetit Ekonomik dhe ndarja në tre Departamente e bën të domosdoshme shtesën për një numër pajisjesh si kompjutera, lap top, printer,fotokopjues etj, me qëllim funksionimin normal të punës brënda cdo departamenti.

Gjithashtu planifikimi i disa paisjeve kompjuteri për Zyrën e e Kurrikules dhe Departamentin e Gjuhëve të Huaja pasi duke parë realisht gjëndjen e paisjeve ekzistuese edhe nga specialistët e IT-së është sugjeruar rinovimi i kompjuterave të cilët janë shume të vjetër dhe kanë edhe problematikën e përshtatjeve të programeve në to apo mos riparimin e tyre si paisje të modeleve të vjetra.

d) Paisje mobileri : planifikohet një fond prej 800.000 lekë kryesisht për blerje katedrash,tavolina pune,banga,rafte për bibliotekën etj.

e)Mjete didaktike mësimore, planifikuar në një vlerë prej 100.000 lekë për përmirësimin e nivelit të mësimdhënies dhe të konkretizimit të orës mësimore në praktikë.

f) Për zërin libra për bibliotekën dhe studentët është parashikuar blerja e një kontigjenti librash për bibliotekën dhe studentët në vlerën prej 2.500.000 lekë.Ky fond është planifikuar në nivel më të lartë në krahasim me vitin e kaluar, për shkak të kërkesave gjithnjë në rritje për tituj shkencor dhe mësimor.Rritja e fondit të librave përmbushur edhe një nga rekomandimet e lëna nga grupi i ekspertëve të akreditimit institucional.

g)Për zërin sistemi i kamerave si një detyrim ligjor kemi planifikuar vlerën 300.000 lekë si edhe **instalimi i videprojekteve** në vlerën 100.000 lekë.

Pra jemi në një situatë ku kemi trashëguar 90.635.218 lekë dhe radikalizimi në tërësi i limiteve të përdorimit të të ardhurave të cojë në trashëgimin e një rezerve sado të vogël të të ardhurave, duke zbatuar dhe duke i dhënë vëmendjen e duhur edhe në këtë pjesë të buxhetit politikës së rritjes së qëndrueshme afatmesme të të ardhurave, si një politikë e domosdoshme për të përballuar cdo vështirësi financiare në të adhmen. Prandaj kemi planifikuar të përdorim 75.238.000 lekë.

Një përmbledhje e të gjithë zërave buxhetor për vitin 2018 jepet në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i zërave të Buxhetit	Llogaria Ekonomike	Viti 2018 (në mijë lek)	Viti 2018 (në mijë lekë)
-----	-------------------------------	--------------------	----------------------------	-----------------------------

I	Granti dhe të Ardhura			Buxhet	Ardhura
	Paga personeli,ore suplementare	600	220.000	200.000	20.000
	Sigurime shoqërore	601	30.000.	30.000	0
A	TOTALI	600 + 601	250.000	230.000	20.000
	Shpenzime për fuzionimin mësimor dhe administrativ të institucionit.	602	45.870	39.992	5.878
	Trasferte për abonime	605	500	500	0
B	SHUMA	602+605	46.370	40.492	5.878
C	Bursa për studentët	606	4.500	4.500	0
D	Investime nga te ardhurat (pajse mobileri, kompjuterike, libra)	231	6.800	0	6.800
	Granti, investime	231	0	0	0
	Supervizim,kolaudator	231	3.462		3.462
	Leje Ndërtimi Bashki	230			
	Rikonstruksion dhe shtese e Ish Shtepise Ushtarakeve	231	39.098		39.098
E	Shuma investime të ardhura 230+231		49.360	0	49.360
	TOTALI		350.230	274.992	75.238

Në total, për vitin 2018 planifikojmë shumën prej 350.230.000 lekë, duke pasur si përparësi rikonstrukcionin e ish Shtëpisë së Ushtarakëve, investimi i të cilit është nga të ardhurat e institucionit por njëkohësisht duke i kushtuar rëndësi edhe përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, jetës akademike, mbështetjes studentore, aktiviteteve të ndryshme dhe promovimit të institucionit tonë në rajon e më gjerë.

ADMINISTRATOR

Gentian LLOGO

